

**MË PAK  
PENGESA  
E MË  
SHUMË  
MUNDËSI  
PËR  
NËNAT  
VETUSHQYESE!**



COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Ky publikim është realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës në bashkëpunim me OJQ-në Ec Ma Ndryshe dhe iniciativën e grave dhe vajzave të Prizrenit, FEMaktiv, ndërsa publikimi është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë analizë janë përgjegjësi e KDI-së, Ec Ma Ndryshe dhe FEMaktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

▼ **04-05**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

▼ **6**

METODOLOGJIA

▼ **07-09**

HYRJA

▼ **10-11**

KORNIZA LIGJORE

▼ **12-17**

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE NË PRIZREN

▼ **18**

REKOMANDIME



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

●●  
Shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, në veçanti për nënat vetushqyese, ku ato vazhdojnë të bien në kategorinë e grupeve të dobëta pasi që kanë mundësi të vogla të punësimit

Prindërit kanë përgjegjësi të kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, duke ju ofruar një jetesë të dinjitetshme. Ky parim mbrohet edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato të fëmijëve. Megjithatë, me rritjen e shkurorezimeve dhe ndarjeve dhe të pjesës së fëmijëve të lindur jashtë martesës, duke mos përfshirë edhe vdekjen e njërit prind, familjet me një prind (familjet në të cilat fëmijët rriten vetëm nga një prind) janë më shumë të zakonshme në shumë vende si në rajonet në zhvillim ashtu edhe në ato të zhvilluara. Sipas shënimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vitin 2010, proporcioni i familjeve me një prind në shtetet që kanë ofruar të dhëna ka shkuar nga 4% në Shqipëri e deri në 20% në Letoni. Të njëjtat statistika tregojnë se në rreth tre të katërtat e rasteve (3/4) prindi i vetëm është nëna. Një dukuri e tillë ka të bëjë me faktin se nënave u ipep kujdesi për fëmijët.

Situata e pafavorshme ekonomike, që vjen si rezultat i papunësisë apo pagave të ulëta është vetëm njëri nga faktorët e shumtë, që kufizojnë mundësitë jetësore të nënave vetushqyese dhe fëmijëve të tyre. Kjo ngase nënat vetushqyese preken edhe nga strehimi i pasigurt; kufizimet e lëvizshmërisë; akumulimi i borxhit; shën-

Me rritjen e shkurorezimeve dhe ndarjeve dhe të pjesës së fëmijëve të lindur jashtë martesës, duke mos përfshirë edhe vdekjen e njërit prind, familjet me një prind (familjet në të cilat fëmijët rriten vetëm nga një prind) janë më shumë të zakonshme në shumë vende si në rajonet në zhvillim ashtu edhe në ato të zhvilluara.

deti i dobët fizik dhe mendor; nivelet e ulëta të mbështetjes sociale; përvojat e dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike duke përfshirë dhunën në familje. Të gjitha këto bëjnë që fëmijët e tyre të kenë më pak burime për të korrur sukses në edukim, duke krijuar kështu më pak mundësi për të hyrë në tregun e punës në nivel më konkurrues.

Institucionet e Kosovës gjithashtu kanë konstatuar se, shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, në veçanti për nënat vetushqyese, ku ato vazhdojnë të bien në kategorinë e grupeve të dobëta pasi që kanë mundësi të vogla të punësimit, me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira për fëmijët e tyre.





●●  
**Në drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë specifikuar se ndihma sociale që i ofrohet nënave vetushqyese është prej 50 deri në 100 euro**

Në këtë analizë të shkurtër tregohet se si politikat e Komunës së Prizrenit ofrojnë fare pak lehtësira për nënat vetushqyese në rritjen e fëmijëve dhe për jetesë të dinjitetshme të tyre. Numri i nënave vetushqyese në Komunën e Prizrenit sipas të dhënave jozyrtare aktualisht është rreth 180 sosh. Në drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë specifikuar se ndihma sociale që i ofrohet nënave vetushqyese është prej 50 deri në 100 euro dhe pohojnë se duhet krijuar një infrastrukturë për punësimin e nënave vetushqyese në mënyrë që ato të kenë një mirëqenie më afatgjate, si dhe një përqendrim më të madh për zgjidhjen e çështjes së banimit.

Problemet kryesore për këto kategori të grave sipas Qendrës për Punë Sociale në Prizren mbeten çështja e banimit dhe ajo e punësimit. Zyrtarët e QPS-së kanë bërë të ditur se rekomandimet apo konkluzionet e tyre profesionale nuk kanë rezultuar me ofrimin e ndonjë përparësie për nënat vetushqyese.

Ndërsa në hulumtimet e mëparme të organizatave të grave nënat vetushqyese të rajonit të Prizrenit kanë vënë në pah një gjendje të rëndë ekonomike, si dhe një nevojë për mbështetje në kushtet elementare për jetesë. Në krye të listës

**Situata e pafavorshme ekonomike, që vjen si rezultat i papunësisë apo pagave të ulëta është vetëm njëri nga faktorët e shumtë, që kufizojnë mundësitë jetësore të nënave vetushqyese dhe fëmijëve të tyre. Kjo ngase nënat vetushqyese preken edhe nga strehimi i pasigurt; kufizimet e lëvizshmërisë; akumulimi i borxhit; shëndeti i dobët fizik dhe mendor; nivelet e ulëta të mbështetjes sociale; përvojat e dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike duke përfshirë dhunën në familje.**

së prioriteve të nënave vetushqyese janë kërkesat për mbështetje financiare për shkollimin e fëmijëve, punësimin e tyre rregullimin e çështjes së banimit, përmirësimin e kushteve për jetesë, ndihmë financiare nga shteti, etj.

Bazuar mbi këto prioritetet, janë përpiluar edhe disa rekomandime që paraqiten në pjesën e fundit të kësaj analize.





# METODOLOGJIA

Kjo analizë e shkurtër është prodhuar si rezultat i hulumtimit të realizuar nga ekipi i hulumtuesve që janë kontraktuar nga Instituti Demokratik i Kosovës. Ekipi hulumtues përgjatë dy muajve ka analizuar politikat dhe vendimmarrjen e pushtetit lokal, në raport me temën e hulumtuar, sikurse edhe diskutimet e ndryshme publike, por dhe dy punëtoritë e mëparme të organizuara me komunitetin e grave në Prizren. Informatat relevante nga hulumtuesit janë grumbulluar përmes intervistave cilësore por edhe përmes qasjes në dokumente publike, kontakte të drejtpërdrejta

me zyrtarët/et institucionale, komunitetin e grave sipërmarrëse dhe shoqatat e tyre, aktivistët e shoqërisë civile, gazetarët lokal, etj. Në të njëjtën kohë është analizuar korniza ligjore dhe mekanizmat ekzistues në lidhje me temën, teksa janë shqyrtuar edhe hulumtimet e publikuara nga institucionet publike dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile për çështjen në fjalë. Gjithash-tu është shqyrtuar aspekti normativ si dhe veprimet në praktikë të zbatuara nga komuna për krijimin e lehtësirave për nënat vetushqyese në rritjen e fëmijëve dhe jetesë të dinjitetshme.





# HYRJA

Prindërit kanë përgjegjësi të kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, duke ju ofruar një jetesë me të dinjitetshme. Ky parim mbrohet edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato të fëmijëve.

Megjithatë me shtimin e numrit të shkurorëzimeve dhe ndarjeve si dhe të pjesës së fëmijëve të lindur jashtë martesës, e duke mos përfshirë edhe vdekjen e njërit prind, familjet me një prind (familjet në të cilat fëmijët rriten vetëm nga një prind) janë më shumë të zakonshme në shumë vende si në rajonet në zhvillim ashtu edhe në ato të zhvilluara.

Sipas shënimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vitin 2010, proporcioni i familjeve me një prind në shtetet që kanë ofruar të dhëna ka shkuar nga 4% në Shqipëri e deri në 20% në Letoni. Të njëjtat statistika tregojnë se në rreth tre të katërtat e rasteve (3/4) prindi i vetëm është nëna. Një gjë e tillë ka të bëjë me faktin se nënave u jepet kujdesi për fëmijët.

**Prindërit kanë përgjegjësi të kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, duke ju ofruar një jetesë me të dinjitetshme. Ky parim mbrohet edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato të fëmijëve.**

Nënat vetushqyese me fëmi(jë) sipas të dhënave të kësaj organizate kanë më shumë gjasa që të përballen me kushte sfiduese socio-ekonomike. Për shembull, nënat vetushqyese kanë më shumë probabilitet që të jenë në gjendje të rëndë ekonomike në krahasim me nënat që jetojnë me një partner apo në krahasim me një baba vetushqyese.<sup>1</sup>

Artikujt dhe hulumtimet tregojnë se, gratë pothuajse gjithkund kanë gjasa më të mëdha të jetojnë në varfëri për shkak të pjesëmarrjes së kufizuar në tregun e punës dhe të ardhurave të ulëta. Kjo për shkak se probabiliteti për to është

1 "The World's Women 2015 - Trends and Statistics", Department of Economic and Social Affairs, UN, 2015; linku: [https://unstats.un.org/unsd/gender/downloads/WorldsWomen2015\\_report.pdf](https://unstats.un.org/unsd/gender/downloads/WorldsWomen2015_report.pdf), qasur më 22 korrik 2017





që të punojnë me orar të shkurtuar apo në vende pune që paguhen më pak përderisa janë kujdestaret kryesore të fëmijëve. Por situata e pafavorshme ekonomike është vetëm njëri nga faktorët e shumtë që kufizojnë mundësitë jetësore të nënave vetushqyese dhe fëmijëve të tyre. Kjo ngase nënat vetushqyese preken edhe nga strehimi i pasigurt; kufizimet e lëvizshmërisë; akumulimi i borxhit; shëndeti i dobët fizik dhe mendor; nivele të ulëta të mbështetjes sociale; përvojat e dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike duke përfshirë dhunën në familje. Të gjitha këto bëjnë që fëmijët e tyre të kenë më pak burime për të korrur sukses në edukim, duke krijuar kështu më pak mundësi për të hyrë në tregun e punës në nivel më konkurrues.

Në vitin 2011, diku 5% të grave në Evropë kanë qenë nëna vetushqyese, rreth 85% të rasteve moshë e tyre silllej prej 25 deri në 64 vjeçe. Njëkohësisht ato i kanë ndjerë më së rëndi pasojat e krizës ekonomike e financiare, ku pjesa më e goditur e nënave vetushqyese ka qenë e moshës 25 deri në 40 vjeçe.<sup>2</sup>

Bazuar në statistika nënat vetushqyese në gjithë Evropën kanë nivel më të ulët të shkollimit krahasuar me nënat që jetojnë me bashkëshortët e tyre, gjë që i bën ato të pakualifikuara për punë, kështu që nënat vetushqyese duhet të bëjnë punë me orar të shkurtuar apo në vende pune që

paguhen më pak, duke ua vështirësuar sigurimin e një jetese të balancuar për fëmijët e tyre apo avancimin në tregun e punës.<sup>3</sup>

Edhe vet institucionet e Kosovës kanë konstatuar se shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, në veçanti për nënat vetushqyese. Ato vazhdojnë të bien në kategorinë e grupeve të dobëta, pasi që kanë mundësi të vogla të punësimit, me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira për fëmijët e tyre.<sup>4</sup>

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e papunësisë për gratë për vitin 2014 ishte 41.6% kundrejt 33.1% të burrave përderisa në vitin 2015 për gratë ishte 36.6% karshi burrave me 31.8%. Ndërsa burimet e të hyrave individuale në Kosovë për vitin 2015, sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare për gratë ishin të hyrat nga rrogat, pensionet si dhe paratë e gatshme dërguar nga familjarët të cilët jetojnë ne diasporë. Gjithnjë sipas raporteve të ASK-së gratë kryefamiljare në vitin 2015 kanë pasur përbërje prej 12% , që reflekton rritje prej 4% krahasuar me vitin 2014.

Pos punësimit, një tjetër sfidë për nënat vetushqyese mbetet strehimi. Pjesëmarrja e grave në pronësi (të pronës së paluajtshme) në Kosovë vazhdon të mbetet në nivel të ulët. Në vitin 2015, gratë kishin në pronësi shtëpinë apo banesën

2 "Report on the situation of single mothers", European Parliament, 2011, linku: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+REPORT+A7-2011-0317+0+DOC+XML+V0//EN&language=hr#title1>

3 Po aty

4 "Strategjia e rishikuar për ri-integrimin e personave të riatdhesuar", Qeveria e Kosovës, 2010, Linku: <https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia%20per%20Riintegrimin%20e%20personave%20te%20Riatdhesuar.pdf>, qasur më 10 gusht 2017







vetëm në 5% të rasteve, përqindje kjo mjaft e ulët që ndikon në pozitën e nënave vetushqyese. Njëkohësisht sipas rezultateve të dala nga Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë në vitin 2014, vetëm 4.9% femra ishin bartëse të pronësisë së tokës bujqësore.<sup>5</sup>

Të gjithë faktorët e sipërpërmendur vështirësojnë pozitën e gruas në shoqërinë kosovare, e veçanërisht të nënave vetushqyese për sigurimin e një jetese të dinjitetshme për vetveten dhe fëmijët e tyre.

Ndërkohë politikat publike vazhdojnë të krijohen në bazë të roleve tradicionale gjinore, duke përfshirë mendësinë që burrat duhet të jenë të vetmit ose përfituesi kryesor në një familje. Gjithashtu tregu i punës është ndërtuar në mënyrën që i avancon më shumë burrat në krahasim me gratë dhe këtu pa dyshim kanë pasur ndikim normat tradicionale. Kjo gjendje vazhdon të formësojë dhe pengojë mundësitë e përfshirjes së grave në tregun e punës, gjendje e cila bëhet më e vështirë për nënat vetushqyese, duke mos u mundësuar kushte të nevojshme për jetesë me dinjitet bashkë me fëmijët e tyre.

**Artikujt dhe hulumtimet tregojnë se, gratë pothuajse gjithkund kanë gjasa më të mëdha të jetojnë në varfëri për shkak të pjesëmarrjes së kufizuar në tregun e punës dhe të ardhurave të ulëta**

---

<sup>5</sup> Po aty





# KORNIZA LIGJORE

Në aspektin legjislativ, Kosova ka një kornizë ligjore të avancuar për të drejtat e grave. Fillimisht Kushtetuta e Kosovës ngërthen në vete parimet e përgjithshme të barazisë dhe mosdiskriminimit. Në të njëjtën kohë pjesa dërmuese e ligjeve kanë dispozita që trajtojnë barazinë gjinore. E dispozita më specifike lidhur me nënat vetushqyese përmban Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Ligji për Barazi Gjinore garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Republikës së Kosovës ndalon të gjitha format e diskriminimit në shoqëri, përfshirë këtu edhe diskriminimin në baza gjinore. Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjisllacionit. Ligji i Punës, obligon punëdhënësi që të krijojnë kushte të barabarta për të dy gjinitë, por edhe të respektojnë pushimin e lehonisë. Ligji për Trashëgiminë i Kosovës thekson se gratë dhe burrat kanë të

drejta të barabarta në trashëgimi. Poashtu ka edhe mekanizma ligjorë që janë të ngarkuar për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Në nivelin qendror janë: Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, mundësi të barabarta dhe kundër diskriminim, Zyret për Barazi Gjinore nëpër ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj *Institucioni i Avokatit të Popullit* e Këshilli ndërministror për Barazi Gjinore. Ndërsa në nivelin lokal janë Zyret për barazi gjinore në të gjitha komunat. Programi i Kosovës për barazi gjinore paraqet një program strategjik për integrimin e barazisë gjinore në politikatat dhe programet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.<sup>6</sup>

Ndërkaq dispozita më specifike lidhur me nënat vetushqyese përmban Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.<sup>7</sup> Me këtë ligj “prindi vetushqyes” përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës. “Person i/e varur” përkufizohet edhe prindërit

6 Doracak “Legjisllacioni që promovon dhe mbron barazinë gjinore në Kosovës, shoqata NORMA, linku: [http://www.norma-ks.org/repository/docs/doracak\\_\(2\).pdf](http://www.norma-ks.org/repository/docs/doracak_(2).pdf), qasur më 12 gusht 2017

7 Ligji Nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, GZK, linku <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2460>, qasur më 22 korrik 2017





vetushqyes me së paku një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

Sipas këtij ligji, këta të fundit, konsiderohen të paaftë për punë të shpërblyeshme. Ndërsa sipas nenit 3.1 të këtij ligji, “skema e ndihmës sociale ofron ndihmë financiare familjeve të përzgjedhshme në përputhje me kriteret e parapara në këtë ligj dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës”.

Ligji për familjen i Kosovës parasheh që për realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet familjare, nënës dhe fëmijës u sigurohet mbrojtje e posaçme me mjete të mirëqenies sociale. Sipas këtij ligji përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë. Për të realizuar kujdesin prindëror dhe për të zbatuar parimet e nenit 128 të këtij Ligji, prindërit janë të detyruar

**Ligji për Barazi Gjinore garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Republikës së Kosovës ndalon të gjitha format e diskriminimit në shoqëri, përfshirë këtu edhe diskriminimin në baza gjinore.**

personalisht të japin kontributin e tyre si dhe të shfrytëzojnë shërbimet e institucioneve shoqërore nëse është e nevojshme.<sup>8</sup>

Ligji i Punës parasheh se punëdhënësi nuk mund të bëjë zgjatjen e orarit të punës për prindin vetushqyes me fëmijë më të ri se tri vjeç dhe se prindi vetushqyes ka të drejtë në pushim vjetor edhe për dy ditë pune shtesë.<sup>9</sup>

<sup>8</sup> Ligji Nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, GZK, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410>, qasur me 23 korrik 2017

<sup>9</sup> Ligji nr.03/L-212 i Punës, GZK, Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>, qasur me 24 korrik 2017





# ANALIZA E GJENDJES NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Numri i nënave vetushqyese në Komunën e Prizrenit sipas të dhënave jozyrtare aktualisht është rreth 180 sosh, ndërkohë që institucionet përgjegjëse nuk kanë ofruar ndonjë të dhënë zyrtare në këtë drejtim. Shkaqet që çojnë te të qenit prind vetushqyes janë të ndryshme. MPMS harton dhe zbaton politikat që kryesisht kanë të bëjnë me ndihmën sociale për këtë kategori, teksa përkrahja e Komunës së Prizrenit për sigurimin e banimit social për këtë kategori mbetet e ulët.

Sipas hulumtimeve të mëparshme, të organizatës së grave “Dora Dorës” del se në periudhën e pasluftës dy shkaqe kryesore kanë ndikuar në rritjen e numrit të nënave vetushqyese në rajonin e Prizrenit.

E para ka qenë lufta e fundit në Kosovë, që ka lënë një numër të grave pa bashkëshortë, të cilat janë kujdesur për fëmijët e tyre dhe e dyta, shkurorëzimet.<sup>10</sup> Këtu nuk duhet përjashtuar edhe vdekjet e natyrshme apo në aksidente të njërit prind.

Në Kosovë në vitin 2016, janë shkurorëzuar 1 mijë e 110 çifte bashkëshortore. Sipas kohëzgjatjes së martesës, dominonte viti i parë me 15.2%, viti i dytë me 12.6% dhe më pak se një vit 8.7% të të shkurorëzuarve. Shkurorëzimet sipas grupmoshave, dominonin gratë e moshës 25-29 vjeçare me 230 shkurorëzime, ose 20.7%. Kurse, te burrat dominojnë moshat 30-34 vjeçe me 233, ose 21%. Sipas përgatitjes shkollore, dominojnë gratë dhe burrat me shkollë të mesme. Numri i grave të kësaj kategorie është 402, ose 36.2%, kurse e burrave 484, ose 43.6%. Numri më i madh i bashkëshortëve të shkurorëzuar janë pa fëmijë me 65.8%, pastaj vijnë me dy fëmijë me 12.5% dhe me një fëmijë me 11.0%.<sup>11</sup>

**Në Prizren në vitin 2016 janë regjistruar 74 shkurorëzime, ku në 49 raste çiftet bashkëshortore nuk kanë fëmijë, në 10 raste kanë një fëmijë, në 7 raste kanë dy fëmijë, në 6 raste kanë tre fëmijë, në 1 rast kanë 4 fëmijë dhe 1 rast kanë më shumë se pesë fëmijë.<sup>12</sup>**

10 “Analiza e gjendjes të nënave vetushqyese në rajonin e Prizrenit”, publikim i OJQ “Dora Dorës”, 2009, linku: [http://www.doradores.org/repository/docs/SINGLE\\_MOTHERS\\_ANALYZE.pdf](http://www.doradores.org/repository/docs/SINGLE_MOTHERS_ANALYZE.pdf), qasur më 16 gusht 2017

11 “Statistikat e Shkurorëzimeve në Kosovë, 2016”, ASK, linku: <http://ask.rks-gov.net/media/3503/skurorizimet-2016-shqip.pdf>, qasur me 8 gusht 2017

12 Po aty





KOMUNA  
PRIZREN



Gjithsej  
shkurorëzime në  
vitin 2016

**74**



## NUMRI I FËMIJËVE

Pa fëmijë

Një

Dy

Tre

Katër

Pesë  
e më  
shumë

**49**

**10**

**7**

**6**

**1**

**1**



Në krye të listës së prioriteve të nënave vetushqyese janë kërkesat për mbështetje financiare për shkollimin e fëmijëve, punësimin e tyre rregullimin e çështjes së banimit, përmirësimin e kushteve për jetesë, ndihmë financiare nga shteti etj.

Sipas hulumtimit të organizatës së grave “Dora Dorës” nënat vetushqyese në rajonin e Prizrenit, të cilat kanë bashkëshortët e vrarë në luftë, marrin pensionet për dëshmorë të luftës, ndërsa nënat tjera vetushqyese nuk gëzojnë ndonjë mbështetje adekuate institucionale përveç ndihmës sociale ku një nga kriteret është prindi vetushqyës që ka fëmijë deri në moshën 15 vjeçare. Gjendja më e rëndë ka qenë në mesin e nënave vetushqyese, të cilat kanë bashkëshortët e humbur në luftë.<sup>13</sup> Në analizë thuhet se gjendja e grave përfshirë edhe nënat vetushqyese, bëhet edhe më pak e kënaqshme duke pas parasysh edhe faktin mbi të drejtën e pronësisë, që jetësohet në nivel të ulët, me ç’rast një gjë e tillë e vështirëson pozitën e gruas, sidomos në rastet e dhunës ndaj saj dhe në rastet e shkurorëzimit. Edhe niveli i punësimit mbetet në nivele të pakënaqshme, që reflektohet negativisht edhe te nënat vetushqyese. Aty pohohet se pozita e gruas në zonat rurale është edhe më e vështirë në krahasim me zonat urbane. Qëndrimi i drejtue-

seve të kësaj organizate është se “nënat vetushqyese, si një kategori e shoqërisë, meritojnë një kujdes dhe përkrahje institucionale, për t’ua rikthyer vetëbesimin dhe dinjitetin.”<sup>14</sup>

Analiza tregon se, një pjesë e konsiderueshme e nënave vetushqyese janë të varura nga anëtarë të tjerë të familjes, përkatësisht jetojnë në bashkësi familjare. Ndërkohë edhe niveli i papunësisë është më i lartë për këtë kategori të nënave, edhe pse shumica e këtyre nënave kanë shkollim të mesëm, intensiteti i trajnimeve profesionale është i ulët. Ndërkohë ekonomia familjare e këtyre nënave varet nga burime të ndryshme.<sup>15</sup>

Sa i përket nevojave të tyre, në përgjithësi sipas hulumtimit në fjalë, nënat vetushqyese kanë vënë në pah një gjendje të rëndë ekonomike, si dhe një nevojë për mbështetje në kushtet elementare për jetesë. Në krye të listës së prioriteve të nënave vetushqyese janë kërkesat për mbështetje financiare për shkollimin e fëmijëve, punësimin e tyre rregullimin e çështjes së

13 “Analiza e gjendjes të nënave vetushqyese në rajonin e Prizrenit”, publikim i OJQ “Dora Dorës”, 2009, linku: [http://www.doradores.org/repository/docs/SINGLE\\_MOTHERS\\_ANALYZE.pdf](http://www.doradores.org/repository/docs/SINGLE_MOTHERS_ANALYZE.pdf), qasur më 16 gusht 2017

14 Po aty

15 Po aty



Ndihma sociale që i ofrohet nënave vetushqyese është prej **50 deri në 100 euro**, varësisht nga kriteret që vlerësohen për të konstatuar nëse familja është në gjendje të rëndë ekonomike, të mesme, apo nuk i plotëson kriteret për t'u futur në skemë. DPMS thekson se buxheti i SNS vjen direkt prej MPMS.

banimit, përmirësimin e kushteve për jetesë, ndihmë financiare nga shteti etj.<sup>16</sup>

Komunat në territorin e Republikës së Kosovës, përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS), dhe në mbikëqyrje të MPMS-së, janë përgjegjëse për administrimin e Skemës së Ndhimave Sociale.<sup>17</sup> Zyrtaret e QPS-së kanë bërë të ditur se kjo qendër ka dy njësi, atë të shërbimeve sociale profesionale dhe të skemës së ndihmave sociale. Në këtë rrafsh, sipas tyre ka ndërlydhje me nënat vetushqyese sepse mjetet financiare jepen nga Skema për Ndhimë Sociale që e monitoron ministria, kurse shërbimet, lehtësimet, në aspektin emocional bëhen nga shërbimi social, ku trajtohen të gjitha aspektet, familjare, shoqërore të fëmijëve, në riintegrimin e tyre në shkollë, rehabilitim etj. Sa i përket shërbimit profesional për nënat vetushqyese, sipas zyrtareve të QPS-së komuna për momentin nuk ofron ndonjë shërbim, edhe pse vet QPS-ja është pjesë e komunës. Çështja kryesore problematike për

nënat vetushqyese sipas kësaj qendre qëndron tek banimi social. QPS ka drejtuar kërkesa në këtë drejtim te Komuna, mirëpo kjo e fundit si prioritet kishte caktuar ndarjen e banesave për familjet e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës. Nga ky vit është kërkuar që Komuna të ndajë banesa për rastet si nënat vetushqyese, rastet e dhunës, fëmijët nën kujdestari. Kategorizimi i nënave vetushqyese sipas QPS-së ndahet në gratë e veja, gratë e shkurorezuara, gratë e ndara nga burri e që janë braktisur nga familja, gjë që edhe ndikon në mënyrën e trajtimit që e marrin nga kjo qendër. Problemet kryesore për këto kategori të grave mbeten çështja e banimit dhe ajo e punësimit. Qendra për Punë Sociale (QPS) ka konfirmuar se deri tani nënave vetushqyese nuk i është ofruar ndonjë përparësi në formë rekomandimi ose konkludimi profesional nga kjo qendër.<sup>18</sup>

Ndërsa në drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë precizuar se ndihma sociale që i

<sup>16</sup> Po aty

<sup>17</sup> Udhëzim Administrativ nr.01/2010 për procedurat për delegimin e përgjegjësive për Skemën e Ndhimave Sociale në nivelin komunal, Qeveria e Kosovës, linku: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/UA\\_nr.01-2010\\_per\\_procedurat\\_per\\_delegimin\\_e\\_pergjegjesive\\_per\\_skemen\\_e\\_ndihmes\\_sociale.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/UA_nr.01-2010_per_procedurat_per_delegimin_e_pergjegjesive_per_skemen_e_ndihmes_sociale.pdf), qasur me 29 gusht 2017

<sup>18</sup> Intervistë me zyrtaren e QPS Prizren, QPS, 23 korrik 2017



Fëmijëve që janë viktimë të dhunës familjare mbështetet në saje të projekteve me **5.000 euro** nga Komuna dhe me dru për ngrohje.

ofrohet nënave vetushqyese është prej 50 deri në 100 euro, varësisht nga kriteret që vlerësohen për të konstatuar nëse familja është në gjendje të rëndë ekonomike, të mesme, apo nuk i plotëson kriteret për t'u futur në skemë. DPMS thekson se buxheti i SNS vjen direkt prej MPMS. Sipas këtij dikasteri nënat vetushqyese kanë përparësi në përfitimin e mjeteve, qoftë materiale apo ndërtimore, futje në skemën sociale, derisa ekziston dhe rasti ku, një nëne vetushqyese i është dhënë banesa sociale. Në një rast tjetër, një nëne vetushqyese i janë ofruar lehtësira si: lirimi nga pagesa e ujit, rrymës, lëndët djegëse. Zyrtaret e DPMS-së kanë theksuar se Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve që janë viktimë të dhunës familjare mbështetet në saje të projekteve me 5.000 euro nga Komuna dhe me dru për ngrohje. DPMS konsideron se duhet krijuar kushte për punësimin e nënave vetushqyese për të siguruar një mirëqenie më afatgjate për to, si dhe zgjidhja e çështjes së banimit të jetë njëra nga prioritetet kryesore.<sup>19</sup>

Zyra për barazi gjinore në komunën e Prizrenit nuk ka zbatuar ndonjë projekt apo iniciativë të veçantë për nënat vetushqyese. Por ato i ka referuar kryesisht te Qendra Rajonale e Punësimin, ku sipas kësaj zyreje ofrohen kurse për kualifikim dhe rrikualifikim. Zyrtaret e këtij organi komunal kanë njohuri se një nëne vetushqyese i është dhënë banesa sociale për strehim. Ndërkaq për raste të tjera kanë thënë se nuk kanë informata, pasi përgjegjësia për trajtimin e rasteve të tilla sipas Zyrës për barazi gjinore i takon Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.<sup>20</sup>

Në anën tjetër përfaqësueset politike nga subjektet opozitare në Prizren kanë vlerësuar se qeveria lokale e Prizrenit nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për përmirësimin e situatës socio-ekonomike të nënave vetushqyese. Aktivistet politike nga opozita kanë theksuar se idetë për mbështetjen modeste të këtyre nënave nuk janë përfillur nga organet komunale, sikurse që nuk është shtruar për diskutim as çështja e

<sup>19</sup> Intervistë me drejtoreshën e DPMS-së, Sherife Balaj, Komuna Prizren, 21 korrik 2017

<sup>20</sup> Intervistë me Mybexhele Zhurin, Koordinatorë në Zyrën për Barazi Gjinore, Komuna e Prizrenit, 18 korrik 2017





Politikat e Komunës së Prizrenit ofrojnë fare pak lehtësira për nënat vetushqyese në rritjen e fëmijëve dhe jetesë të dinjitetshme. Duke pas parasysh faktin se nënat që kanë mbetur të veja dhe duhet të mbajnë mbi supe përgjegjësinë për familjet e tyre për shkak se ballafaqohen me sfidat ekonomike dhe të tjera, organet komunale duhet të bëjnë përpjekje që ta lehtësojnë këtë barrë dhe t'i mundësojnë nënave që të tregojnë kujdesin e duhur prindëror për fëmijët e tyre.

ndarjes së një linje buxhetore për nënat vetushqyese. Sipas përfaqësuesve politike opozitare, ekzekutivi lokal nuk ka zbatuar, as nuk ka hartuar ndonjë politikë për përmirësimin e gjendjes së nënave vetushqyese.<sup>21</sup>

Politikat e Komunës së Prizrenit ofrojnë fare pak lehtësira për nënat vetushqyese në rritjen e fëmijëve dhe jetesë të dinjitetshme. Duke pas parasysh faktin se nënat që kanë mbetur të veja dhe duhet të mbajnë mbi supe përgjegjësinë për familjet e tyre për shkak se ballafaqohen me sfidat ekonomike dhe të tjera, organet komunale duhet të bëjnë përpjekje që ta lehtësojnë këtë

barrë dhe t'i mundësojnë nënave që të tregojnë kujdesin e duhur prindëror për fëmijët e tyre. Njëkohësisht edhe nënat e shkurorëzuara duke mos pasur kualifikimet e mjaftueshme për punë mund të ballafaqohen me sfida ekonomike dhe të pranojnë angazhimin në vende pune me paga të ulëta, prandaj meritojnë një mbështetje më të madhe nga Komuna, për t'ju lehtësuar sfidat me të cilat përballen në rritjen e fëmijëve ashtu që kjo përgjegjësi mos t'i mbetet vetëm rrethit familjar.

Në anën tjetër nënat e pamartuara vetushqyese ballafaqohen me probleme emocionale, krahas atyre socio-ekonomike. Ndjenja e mos respektit ndaj vetes dhe të qenurit e refuzuar, mund t'i bëjë këto nëna më të pa përkushtuara ndaj nevojave emocionale të fëmijëve. Prandaj, nënat e kësaj kategorie kanë nevojë për përkrahje më të madhe në aspektin material dhe social. Pos kësaj, nënat vetushqyese që hyjnë për herë të parë në tregun e punës mund të përballen me vështirësi në balancimin e raporteve punë-shtëpi-fëmijë, prandaj duhet të gëzojnë një mbështetje për edukimin parashkollor dhe shkollor të fëmijëve të tyre.

21 Intervistë përmes e-mailit me Drita Millakun, ish-këshilltare në KK e Prizrenit, tani deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e LVV, 24 korrik 2017



# REKOMANDIMET

1

Duke qenë se në krye të listës së prioriteteve të nënave vetushqyese janë kërkesat për mbështetje financiare për shkollimin e fëmijëve, Komuna e Prizrenit në kuadër të politikave të saja publike duhet të planifikojë ofrimin e bursave dhe lehtësirave tjera për edukimin parashkollor dhe shkollor të fëmijëve të këtyre nënave;

2

Komuna e Prizrenit duhet të intensifikojë politikat e saja për arritjen e barazisë gjinore, sidomos për përfshirjen e grave në tregun e punës, me ç'rast një kujdes i veçantë duhet të ofrohet për përkrahjen e punësimit të nënave vetushqyese;

3

Në kuadër të politikave të banimit social, Komuna e Prizrenit urgjentisht duhet të ndërmarrë veprime për adresimin e problemeve të çështjes së banimit për nënat vetushqyese, në mënyrë që të krijohen lehtësira për nënat vetushqyese në rritjen e fëmijëve dhe jetesë të dinjitetshme;

4

Komuna duhet të hartojë politika që mundësojnë ofrimin e shërbimeve më efikase sociale për këtë kategori të nënave, sikurse edhe ndërgjegjësimin e nënave vetushqyese (të shkurorëzuara) rreth të drejtës për alimentacion.



Analiza tregon se, një pjesë e konsiderueshme e nënave vetushqyese janë të varura nga anëtarë të tjerë të familjes, përkatësisht jetojnë në bashkësi familjare. Ndërkohë edhe niveli i papunësisë është më i lartë për këtë kategori të nënave, edhe pse shumica e këtyre nënave kanë shkollim të mesëm, intensiteti i trajnimeve profesionale është i ulët. Ndërkohë ekonomia familjare e këtyre nënave varet nga burime të ndryshme.

This publication is part of the project "United women for a gender friendly political, economic and social governance", implemented by (KDI, Ec ma Ndryshe and FEMaktiv, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

